

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 018/2025
Projekti: Ruajtja dhe Siguria Fizike	Data e dorëzimit: 17 shtator 2025

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit



KËRKESË PËR TENDER (KPT)

01. Informacion i Përgjithshëm i Tenderit

1.1. Tenderi i kërkuar nga: Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit: Rruga "SH81", Parku Kombëtar i Butrintit, Ksamil, Shqipëri.

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit (FMB) është një organizatë jofitimprurëse pa anëtarësi, e bashkëthemeluar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) dhe Fondacioni Shqiptar-Amerikan për Zhvillim.

FMB operon në fushën e trashëgimisë kulturore dhe ka për qëllim administrimin indirekt të nënjonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e PKB ("Pasuria Kulturore"), në përputhje me Marrëveshjen e miratuar me Ligjin 50/2022 "Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënjonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit".

1.2. Objekti i Tenderit: Ofrimi i shërbimeve të sigurisë fizike për nënjonat e trashëgimisë dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit.

1.3. Burimi i financimit: Fondi limit për këtë KPO është: 74,650,000 (me TVSH) për një periudhë 24 mujore. Kjo kërkesë për ofertë financohet nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit.

1.4. Gjuha: Siç përcaktohet nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, gjuha e punës për këtë tender është gjuha shqipe dhe çdo dokument, kontrata, certifikata, referenca të marra nga palë të treta në gjuhë të ndryshme nga ajo shqipe, duhet të përkthehen. Noterizimi nuk është i domosdoshëm për aplikim, por kopjet e noterizuara do t'i kërkojnë fituesit nga Fondacioni për lidhjen e kontratës.

1.5. Dokumentet e Tenderit : Dokumentet e tenderit merren nëpërmjet shkarkimit nga faqja zyrtare e internetit të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, <https://bmf.al/>. Nëse keni pyetje, ju lutemi drejtojeni ato me shkrim ose me e-mail në tenders@bmf.al ose me shkresë në adresën e mësipërme. Format e tjera të komunikimit në lidhje me tenderat nuk pranohen gjatë një procedure ende në proces.

1.6. Dorëzimi i tenderit:

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve (me zarf të mbyllur) është data 17 shtator 2025, ora 12:00. Aplikimi i dorëzuar pas këtij afati nuk do të merret parasysh.

Paraqisni aplikimin tuaj personalisht ose me postë në zyrën e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në Sarandë (adresa e dhënë më sipër).

Për dorëzimin e aplikimeve përmes postës do të merret në konsideratë data dhe ora e dorëzimit sipas vulës së postës. Në rast të dorëzimit me postë, aplikanti duhet të njoftojë Fondacionin për këtë, përndryshe Fondacioni nuk ka detyrim të presë aplikimin për hapjen e ofertave.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 018/2025
Projekti: Ruajtja dhe Siguria Fizike	Data e dorëzimit: 17 shtator 2025

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

Në rastet kur priten aplikime me postë, Fondacioni do të hapë ofertat në momentin që të gjithë aplikimet e pritura kanë arritur ose 7 ditë kalendarike pas datës së mbylljes së tenderit në orën e parashikuar, cilado nga këto ngjarje të realizohet e para.

Sigurooni sa vijon:

- Përgatitni tre grupe dokumentacioni tenderi (një origjinal, një kopje të printuar dhe një kopje elektronike (USB)) dhe një ofertë financiare.
- Vendosini ato në zarfe të mbyllura të etiketuara:
 1. "ORIGJINALE" – përfshin të gjithë dokumentet, pa ofertën financiare që është zarf më vete
 2. "KOPJE E PRINTUAR"- përfshin kopje të të gjithë dokumenteve, si dhe kopje të Ofertës Financiare dhe preventivin/buxhetin e detajuar të printuar nga formati Excel
 3. "KOPJE ELEKTRONIKE (USB)"- përfshin kopje të të gjithë dokumenteve, si dhe kopje elektronike të Ofertës Financiare dhe preventivin në formatin Excel
 4. "OFERTA FINANCIARE" – përfshin vetëm një origjinal dhe një kopje të Ofertës Financiare dhe preventivin/buxhetin e detajuar të printuar nga formati Excel.

Paketimi final i dokumentacionit

Pasi të jenë përgatitur dhe etiketuar të gjitha zarfet sipas udhëzimeve, ato duhet të vendosen së bashku në **një paketë të vetme të mbyllur**. Në pjesën e jashtme të paketës duhet të shënohet qartë:

- a) Emri dhe adresa e aplikantit
- b) Drejtuar: Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit
- c) Identifikimi i procesit të aplikimit, duke përfshirë emrin dhe numrin e tenderit
- d) Paralajmërimi: "TË MOS HAPET PARA DATËS DHE ORËS SË ÇAKTUAR PËR HAPJEN E OFERTAVE"

1.6. Udhëzime për aplikantët

1. Përdorni formularin "Eksperienca të ngjashme" për të theksuar përvojat e kompanisë. Përshkruani qartë rëndësinë e tyre në seksionin e dedikuar. Përdorni ndarës ose skeda për të theksuar faqet ose seksionet e rëndësishme.
2. Merrni parasysh plotësisht kriteret e renditura të vlerësimit, duke vënë në dukje peshat relative të caktuara për rëndësinë e tyre. Shmangni supozimin se çmimi më i ulët garanton sukses.
3. Për të kapërcyer pragun kualifikues të kriterëve individuale prej 60%, paraqisni më shumë kontrata të punëve të ngjashme dhe përvojës së stafit sesa minimumi i kërkuar. Vini re se Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të pranojë maksimumi 5 kontrata të ngjashme.
4. Mos skanoni të gjitha dokumentet në një. Çdo dokument duhet të skanohet dhe të ruhet veçmas, me tituj që tregojnë përmbajtjen.
5. Sigurohuni që USB-ja juaj të funksionojë siç duhet dhe të jetë pa viruse.

1.7. Objekti i shërbimit: Objekti i shërbimit ka të bëjë me të gjitha punët që lidhen me aktivitetet e nevojshme për të përfunduar punët e kërkuara të përshkruara më poshtë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: Ofrimi i Shërbimeve të Sigurisë për nënzonat e trashëgimisë dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit. Më shumë detaje rreth fushës së shërbimit do të gjenden në Termat e Referencës, pjesë e pandarë e dokumentacionit të tenderit.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 018/2025
Projekti: Ruajtja dhe Siguria Fizike	Data e dorëzimit: 17 shtator 2025

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

1.9. Hapja e Aplikimit: Zarfet do të hapen në datën **17 shtator 2025 në orën 12.15**, nga përfaqësuesit e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit. Emri i aplikantit, oferta, çdo zbritje dhe koha e përfundimit do të shpallen dhe regjistrohen në procesverbal.

1.10. Vlerësimi i Aplikimit: Komiteti i Vlerësimit të Tenderit (KVT) do të kontrollojë aplikimet për t'u siguruar që ato nuk përmbajnë ndryshime në terma ose gabime. Për të ndihmuar në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e Aplikimeve, KVT, sipas gjykimit të tij, mund të kërkojë ndihmë nga profesionistë të tjerë në cilësinë e konsulentit të KVT-së. Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit rezervon të drejtën të ndryshojë sasinë e punës/materialeve të specifikuara në Dokumentet e Tenderit pa asnjë ndryshim në çmimin e njësisë ose terma dhe kushte të tjera dhe të pranojë ose refuzojë çdo, të gjitha, ose një pjesë të Aplikimeve të paraqitura pa dhënë arsye për vendim i tillë.

1.11. Vlerësimi Teknik dhe Financiar: Aplikimet do të vlerësohen fillimisht për cilësitë teknike, duke vlerësuar kapacitetin e kompanisë përmes dokumentacionit të dorëzuar. Mangësitë mund të ndikojnë në rezultatet dhe mundësinë për të fituar. Pragjet e cilësisë janë vendosur. Ofertat që shënojnë më pak se **60%** për të paktën një kriter cilësor dhe më pak se **70%** për kriteret cilësore në përgjithësi, do të përjashtohen nga pjesa tjetër e procedurës së vlerësimit.

1.11.1 Vlerësimi financiar pason vlerësimin teknik dhe bazohet në kosto. Kriteri i koston vlerësohet duke i dhënë numrin maksimal të pikëve në dispozicion për kriterin e koston ofertës më të ulët të kualifikuar. Pjesa tjetër e ofertave vlerësohet duke përdorur një formulë që lejon një ulje proporcionale të pikëve.

Ofertat do të shqyrtohen nga afër për të përcaktuar **anomalitë e çmimeve**. Ofertat që vlerësohen nga Komiteti i Vlerësimit të Tenderit si anomalisht të ulëta do të skualifikohen mbi këtë bazë, pavarësisht nga pikët e tyre teknike. Ky vendim kërkon hetim i cili përfshin edhe ofertuesin.

Kriteret	Dokumentacioni	Shpërndarja e pikëve
Kapaciteti i kompanisë për të ofruar shërbimin sipas standardeve	Kontrata për shërbime të ngjashme të kryera, referencat nga institucionet kontraktuese, eksperiencat në site kulturore apo parqe, Lista e stafit kryesor të propozuar, pajimet, uniformat dhe teknologjia e përdorur.	40 %
Përputhshmëria e metodologjisë me kërkesat specifike të sitit.	Metodologjia	20%
Oferta Financiare	Oferta Financiare e Detajuar për Shërbim.	40 %
TOTAL:		100%

1.12. Vlerësime të tjera: Kur cakton kompanitë në listën e përzgjedhur, KVO mund të marrë parasysh kriteret e tjera, duke përfshirë, por pa u kufizuar në kohën e përfundimit, të dhënat e performancës së eksperiencave të mëparshme me Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit ose partnerët, integritetin,

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 018/2025
Projekti: Ruajtja dhe Siguria Fizike	Data e dorëzimit: 17 shtator 2025

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

referencat dhe raportin me komunitetin. Intervistat me kompanitë e renditura në krye, mund të përdoren gjithashtu si një mjet vendimmarrës plotësues.

1.13. Përzgjedhja e fituesit:

Përzgjedhja e aplikantit të suksesshëm do të bazohet në renditjen e tenderave të kualifikuar sipas pikëve kumulative të fituara nga vlerësimi i kriterëve teknike dhe financiare.

1.14. Lista e dokumentacionit që do të dorëzohet:

1. Paketa e tenderit të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit plotësohet në çdo seksion në gjuhën shqipe duke ruajtur renditjen me të gjithë dokumentacionin e kërkuar të bashkangjitur siç përcaktohet në formular.
2. Oferta financiare e shoqëruar me preventivin të printuar, duke përdorur strukturën sipas modelit të Excel të publikuar bashkangjitur këtij tenderi.
3. Ekstrakt historik nga Regjistri Tregtar, të lëshuar nga QKB jo më herët se 30 ditë nga dorëzimi.
4. Licenca e nënkategorisë 1.3.A “Shërbimi i sigurimit fizik të objekteve”;
5. Vërtetim se përfaqësuesi ligjor dhe aksionarët/ortakët e shoqërisë nuk janë dënuar për shkelje penale, si dhe nuk janë në proces hetimi nga ana e organit të prokurorisë, të lëshuar jo më herët se 30 ditë nga dorëzimi;
6. Kopje të pasqyrave financiare të shoqërisë të audituara, të vulosura në çdo faqe nga Autoriteti Tatimor për vitin 2024;
7. Certifikata e titullarit të subjektit;
8. Certifikata e drejtuesit teknik për kategorinë 1.3.A “Shërbimi i sigurimit fizik të objekteve”;
9. Vërtetim i numrit të punonjësve i shoqëruar me listëpagesat për 6 muajt e fundit. Emrat e punonjësve kryesorë të propozuar për shërbimin pranë Parkut Kombëtar të Butrintit duhet të identifikohen nga aplikanti në listëpagesën e tre muajve të fundit.
10. Vërtetim të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Vlorë të 3 muajve e fundit, ku të specifikohen kapacitetet e shoqërisë (punonjës shërbimi, grupe të gatshme, armatim, mjete speciale, automjete, objekte ku ushtron aktivitetin etj.), listë emërore dhe masa administrative, ngjarjet ku është përfshirë kompania gjatë 3 viteve të fundit;
11. Polica e sigurimit të përgjegjësisë publike dhe profesionale, nëse ka, ose deklaratë angazhimi për lidhjen e një police sigurimi të përgjegjësisë publike me mbulim 1,000.000 Euro në vit.
12. Autorizim lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për përdorimin e mjeteve speciale për vitin 2025 e në vijim;
13. CV të shoqërisë për aktivitetin e saj për tre vitet e fundit, ku të përfshihen kontaktet e përfaqësuesve të këtyre institucioneve kontraktuese për referencë (person kontakti, nr. telefoni dhe adresë email);
14. Minimumi dy kopje kontratash të ngjashme të përfunduara në 7 vitet e fundit, të shoqëruara me referenca ose formularë vlerësimi të shërbimit nga institucionet kontraktuese; Numri maksimal i kontratave të pranura do të jetë 5.
 - a Në rastet kur kontratat janë me afat disavjeçar dhe nuk kanë përfunduar, por të paktën një vit është mbyllur, mund të sillet një vërtetim nga pala kontraktuese për këtë qëllim ku të përfshihet edhe vlerësimi për cilësinë e shërbimit të ofruar deri më sot.
15. Lista e emrave të Ekipit Kryesor të planifikuar për të punuar në këtë projekt të shoqëruar me CV-të, diplomat dhe licencat e tyre (aty ku është e aplikueshme). Ekipi Kryesor do të përbëhet nga të paktën këto pozicione individuale:
 - Drejtues Ekipi (punonjës i aplikuesit)
 - Mbikëqyrës i Rojeve (punonjës i aplikuesit)

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 018/2025
Projekti: Ruajtja dhe Siguria Fizike	Data e dorëzimit: 17 shtator 2025

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

- Ekspert IT (punonjës i aplikuesit ose i nën-kontraktorit)
- 16. Metodologjia e punës. Në kuadër të këtij tenderi, metodologjia e punës që do të paraqitet nga kompania pjesëmarrëse duhet të përmbajë një përshkrim të detajuar të mënyrës së organizimit dhe zbatimit të shërbimit të ruajtjes fizike për sitin e mbrojtur UNESCO të Butrintit, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Kompania duhet të paraqesë një plan pune që përfshin vlerësimin e riskut, procedurat e kontrollit të aksesit, masat e sigurisë për ruajtjen e integritetit të sitit, përdorimin e teknologjisë për mbikëqyrje (kamera, sensorë, etj.) pa ndërhyrë në strukturat historike, si dhe procedurat për reagim në raste emergjente. Gjithashtu, kërkohet një program trajnimi për personelin e sigurisë mbi specifikat e punës në një mjedis me vlera të larta kulturore me një shtrirje të gjerë, si dhe mënyra e bashkëpunimit me autoritetet shtetërore dhe institucionet përgjegjëse për menaxhimin e sitit.
- 17. Deklarimi i konfliktit të interesit me çdo drejtor apo menaxher të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, nëse ka. Mungesa e një deklarimi të tillë, nëse ekziston konflikti, do të çojë në përjashtimin nga tenderi aktual dhe përjashtimin e mundshëm nga procedurat e ardhshme të tenderimit.
- 18. Fituesi duhet të paraqesë para nënshkrimit të kontratës dokumentet e mëposhtme:
 - a Vërtetim se ka shlyer detyrimet fiskale dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të lëshuar jo më herët se 30 ditë nga dorëzimi;
 - b Vërtetim nga gjykata se subjekti nuk ka proces gjyqësor të hapur në cilësinë e palës së paditur, të lëshuar jo më herët se 30 ditë nga dorëzimi;
 - c Certifikatat e punonjësve të shërbimit të propozuar për shërbimet e kërkuara

Fituesit do t'i kërkohet të dorëzojë kopjet e noterizuara të të gjithë dokumenteve të tenderit. Çdo ndryshim i dokumenteve do të jetë shkak për dënime të ashpra, deri në përjashtim të përhershëm nga tenderimi në Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit.

02. Kushtet për tender

2.1 Pranueshmëria e aplikantëve: Aplikantët nuk mund të aplikojnë nëse:

- 1- Nuk janë kompani të regjistruara.
- 2- Janë të falimentuar ose në proces falimentimi.
- 3- Kanë qenë fajtorë për shkelje të rënda profesionale.
- 4- Nuk kanë përmbushur detyrimet lidhur me pagesën e sigurimeve të detyrueshme, sigurimet shoqërore dhe taksat.
- 5- Janë fajtorë për keqinterpretim serioze në dhënien e informacionit.
- 6- Janë deklaruar për faj të rëndë zbatimi për shkak të shkeljes së detyrimeve të tyre kontraktuale.
- 7- Janë në ndonjë listë të palëve të sanksionuara të lëshuara nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, Kombet e Bashkuara ose Bashkimi Evropian.
- 8- Mos plotësimi i kriterëve të tjera kualifikuese.

2.2. Kriteret e Kualifikimit:

1. Të jetë i regjistruar në regjistrin tregtar me status aktiv;
2. Të jetë i pajisur me licencë të kategorisë 1.3.A;
3. Përfaqësuesit ligjorë dhe ortakët/aksionarët të mos jenë të dënuar për shkelje penale, si dhe të mos jenë nën proces hetimi nga ana e organit të prokurorisë;
4. Të mos jetë subjekt në proces gjyqësor të hapur në cilësinë e palës së paditur;
5. Të paraqesë minimumi 2 kontrata te ngjashme.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 018/2025
Projekti: Ruajtja dhe Siguria Fizike	Data e dorëzimit: 17 shtator 2025

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

2.3. Informacion shtesë:

- 1- Të gjitha dokumentet e tenderit duhet të plotësohen plotësisht për të shmangur skualifikimin.
- 2- Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit synon të pranojë Aplikimet për kontratë me çmim për njësi (*Kontratat me çmim për njësi, janë marrëveshje ku janë fikse vetëm çmimet e artikujve, ndërsa vëllimet po njësitë mund të ndryshojnë, në varësi të nevojave aktuale të projektit*).
- 3- Çmimet për njësi të kontratës do të jenë fikse gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.
- 4- Fondacioni ka të drejtë të kërkojë ndryshime në numrin e personelit të dedikuar, furnizimet ose vëllimin e shërbimeve të kërkuara në varësi të nevojave të saj pa bere ndryshime ne çmimet për njësi të kontratës.
- 5- **Nënkontraktimi**, nëse është i nevojshëm, lejohet vetëm për krijimin e sallës së monitorimit dhe mirëmbajtjen e sistemit CCTV.
- 6- Nuk lejohet pjesëmarrja në formën e sipërmarrjeve të përbashkëta (Joint Venture – JV).
- 7- Të gjithë aplikantët do të marrin dokumente identike: Asnjë aplikant nuk duhet të shtojë, heqë ose ndryshojë ndonjë term ose kusht në dokumentet origjinale. Nëse e bëjnë, kjo do të jetë arsye për skualifikim të menjëhershëm.
- 8- Nëse aplikantët kanë ndonjë kërkesë dhe kusht për të negociuar, kjo do të përcaktohet në një letër të veçantë që shoqëron aplikimin.
- 9- Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të organizojë një vizitë në terren. Fondacioni do të konsiderojë se çdo aplikant ka vizituar dhe inspektuar vendin në tërësi përpara se të bëjë dhe dorëzojë një aplikim, dhe çdo gabim ose problem që lind nga mungesa e informacionit që mund të ishte marrë në një vizitë të tillë nuk do të merret në konsideratë nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit.
- 10- Çdo aplikant mund të bëjë vetëm një ofertë për këtë KPT të specifikuar.
- 11- Të gjitha çmimet duhet të përfshijnë të gjitha pagesat e detyrueshme, taksat dhe detyrimet. TVSH-ja do të llogaritet dhe tregohet veçmas në mënyrën e treguar në formularët përkatës.
- 12- Sqarimet në lidhje me projektin që nuk adresohen në vizitën në terren duhet t'i dërgohen me shkrim Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit jo më vonë se pesë ditë pune përpara afatit të dorëzimit. Kërkesat mund të dërgohen me e-mail në tenders@bmf.al ose të dërgohen me shkrim në zyrën e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në Sarandë. Përgjigjet për çdo pyetje të ngritur nga çdo aplikant do t'i jepen atij aplikanti me shkrim, nëse është e mundur, brenda dy ditëve të punës. Megjithatë, është kusht i këtij tenderi që asnjë sqarim nuk do të konsiderohet se zëvendëson, kundërshton, shton ose pakëson kushtet e këtij tenderi, përveç nëse ndryshimet bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga Drejtori Ekzekutiv ose përfaqësuesi i tij i caktuar.

Shtesa dhe/ose sqarime në lidhje me këtë tender mund të lëshohen në çdo kohë. Një njoftim në lidhje me shtesa të tilla do të publikohet në faqen e internetit të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, <https://bmf.al/>. Përmbajtja e tyre mund të ndikojë në çmimin dhe kushtet e tenderit. Është përgjegjësi e aplikantit të jetë i informuar.

2.4. Mashtrimi dhe Korrupsioni: Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit kërkon që furnitorët, kontraktorët dhe konsulentët sipas kontratave të tij ose kontratave të tilla të kërkuara, të respektojnë standardet më të larta të etikës gjatë prokurimit dhe ekzekutimit të kontratave. Në ndjekje të një politike të tillë, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit përcakton për qëllimin e kësaj dispozite, kushtet e përcaktuara si më poshtë:

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 018/2025
Projekti: Ruajtja dhe Siguria Fizike	Data e dorëzimit: 17 shtator 2025

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

- a- “Praktikë korruptive” nënkupton ofertën, dhënien, marrjen ose kërkimin e çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në veprimin e punonjësve apo drejtuesve të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në procesin e prokurimit ose në ekzekutimin e kontratës.
- b- “Praktikë mashtruese” nënkupton një keqinterpretim të fakteve me qëllim që të ndikojë në një proces prokurimi ose ekzekutimin e një kontrate në disfavor të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit dhe përfshin praktikën e fshehta të marrëveshjeve të paligjshme midis aplikantëve (para ose pas paraqitjes së Aplikimit) të krijuara për të përcaktuar çmimet e Aplikimit në nivele artificiale, jo konkurruese dhe t'i privojnë huamarrësit përfitimet e konkurrencës së lirë dhe të hapur.

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të refuzojë një propozim nëse konstaton se aplikanti është përfshirë në praktika korruptive ose mashtruese në konkurrim për kontratën. Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të deklarojë gjithashtu një entitet si të papërshtatshme për t'i dhënë një kontratë, qoftë për një kohë të pacaktuar ose për një periudhë të caktuar kohore, nëse konstaton se entiteti është përfshirë në praktika korruptive ose mashtruese në konkurrim ose në ekzekutimin e një kontrate të financuar nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit.

Ndalohet kontakti i drejtpërdrejtë me punonjësit ose drejtuesit e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në lidhje me paraqitjen e ofertës tuaj gjatë periudhës së vlerësimit të tenderit.

Çdo përpjekje e aplikantëve për të ndikuar përfaqësuesit e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në vlerësimin e ofertave ose vendimeve për dhënien e kontratës do të rezultojë në refuzimin e menjëhershëm të aplikimit të tyre.

2.5. Ndryshimi i Dokumentit të Tenderit: Në çdo kohë para afatit të fundit për dorëzimin e tenderave, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit mund të ndryshojë Dokumentin e Tenderit duke lëshuar një shtesë. Çdo shtesë e lëshuar do të jetë pjesë e Dokumentit të Tenderit dhe do t'u komunikohet me shkrim të gjithë atyre që janë regjistruar dhe kanë marrë pjesë në vizitën në terren. Për t'u dhënë aplikantëve të mundshëm kohë të arsyeshme për të marrë parasysh një shtesë në përgatitjen e aplikimeve të tyre, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, sipas gjykimit të saj, mund të zgjasë afatin për dorëzimin e aplikimeve.

2.6. Tërheqja, zëvendësimi dhe modifikimi i aplikimeve: Një aplikant mund të tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë aplikimin e tij pasi të jetë dorëzuar duke dërguar një njoftim me shkrim, të nënshkruar siç duhet nga një përfaqësues i autorizuar. Të gjitha njoftimet duhet të merren nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit përpara afatit të përcaktuar për dorëzimin e aplikimeve. Aplikimet e tërhequra do t'u kthehen të pahapura aplikantëve. Asnjë tender nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet në intervalin ndërmjet afatit të fundit për dorëzimin e tenderit dhe skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të specifikuar nga aplikanti në dokumentet e tenderit ose në ndonjë zgjatje të tyre.

2.7. Vlefshmëria e ofertës: Çdo ofertë do të jetë e vlefshme për të paktën 150 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të saj.

2.8. Periudha e Performancës: Kjo kontrate do të ketë një afat 2 vjeçar nga data e nënshkrimit.

2.9. Standardet e Performancës: Shërbimet duhet të ndërmerren brenda të gjitha rregullave, rregulloreve dhe ligjeve përkatëse në fuqi aktualisht në Shqipëri dhe nga praktikatat më të mira të industrisë.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 018/2025
Projekti: Ruajtja dhe Siguria Fizike	Data e dorëzimit: 17 shtator 2025

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

2.10. Vizita në terren: Kompanitë duhet të marrin pjesë në një vizitë në terren të organizuar nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit. Gjatë kësaj vizite, aplikantët e mundshëm do të kenë mundësinë të adresojnë pyetje dhe të marrin sqarime në lidhje me aspekte të ndryshme të paraqitjes së tenderit.

Vendi i Takimit	Koha	Data
Butrint, Parku Kombëtar i Butrintit	ora 12:00	22 gusht 2025

2.11. Kostoja e aplikimit: Aplikanti do të përballojë të gjitha kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e Aplikimit të tij dhe Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjëse për ato kosto, pavarësisht nga zhvillimi ose rezultati i procesit të aplikimit.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 018/2025
Projekti: Ruajtja dhe Siguria Fizike	Data e dorëzimit: 17 shtator 2025

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

1 . Formulari i Ofertës Financiare

Aplikanti:

Për Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit,

Pasi kemi shqyrtuar dokumentet e kërkuara për aplikimin në tenderin e sipërpërmendur, ne ofrojmë të kryejmë dhe të kryejmë shërbimet e kërkuara për shumën e llogaritur

_____ Lekë (**Pa TVSH**)
(Me shifra dhe fjalë)

Oferta jonë është e vlefshme për 150 ditë kalendarike nga data e caktuar për afatin e dorëzimit të tenderit në përputhje me Dokumentet e Tenderit, dhe ajo do të mbetet e detyrueshme për ne dhe mund të pranohet në çdo kohë përpara skadimit të asaj periudhe;

Për të ofruar çmimin e lartpërmendur, ne pranojmë se kemi marrë në konsideratë të gjitha dokumentet e shpallura të tenderit, duke përfshirë shtojcat.

Ne marrim përsipër që nëse oferta jonë pranohet të fillojmë ofrimin e shërbimit brenda _____ ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës dhe të përfundojmë në përputhje me kontratën brenda afatit kohor të rënë dakord me Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit dhe në përputhje me informacionin në këto Dokumente Tenderi.

Ne e kuptojmë se ky Tender, së bashku me pranimin tuaj me shkrim të përfshirë në njoftimin tuaj për njoftimin e fituesit, do të përbëjë një kontratë detyruese mes nesh derisa të përgatitet dhe ekzekutohet një kontratë formale.

Ne e kuptojmë dhe pranojmë që Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit nuk është i detyruar të zgjedhë çmimin më të ulët ose ndonjë aplikim që mund të merret, dhe se çdo ose të gjitha Aplikimet mund të refuzohen pjesërisht ose plotësisht pa caktuar ndonjë arsye për një refuzim të tillë.

Nëse fitohet kontrata, personi i përmendur më poshtë do të veprojë si Përfaqësues i Kontraktorit:

_____ (Emri, mbiemri, nënshkrimi)
Përfaqësuesi ligjor.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 018/2025
Projekti: Ruajtja dhe Siguria Fizike	Data e dorëzimit: 26/05/2025

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

2. Eksperiencë e ngjashme

Aplikanti:

PLOTËSONI NJË (1) FORMULAR PËR ÇDO KONTRATË DHE BASHKËLIDHNI KONTRATËN OSE REFERENCËN NGA INSTITUCIONI KONTRAKTUES

Kontratë me madhësi dhe natyrë të ngjashme			
Identifikimi dhe përshkrimi i kontratës			
Kontratë e paraqitur në përgjigje të kërkesave për kualifikim	☐	Kontratë e paraqitur për pikë shtesë	☐
Data e fillimit		Data e përfundimit	
Roli në kontratë	Kontraktor kryesor		Nënkontraktor
Shuma totale e kontratës			
Shuma totale e komponentit të shërbimit (e rëndësishme nëse kontrata përmban elementë të ndryshëm nga shërbimet e tenderit, blerja e pajisjeve, mobiljeve etj.)			
Nëse është partneritet në një sipërmarrje të përbashkët ose nënkontraktor, specifikoni pjesëmarrjen në shumën totale të kontratës	Përqindja e totalit	Shuma	
Kontraktuar nga: Adresë Emri i kontaktit Numri i telefonit/celularit: E-mail:			
Përshkrimi i ngjashmërisë			
PËRSHKRUANI SHKURTIMISHT PËRSE KJO KONTRATË ËSHTË E NGJASHME ME SHËRBIMIN E KËRKUAR.			

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 018/2025
Projekti: Ruajtja dhe Siguria Fizike	Data e dorëzimit: 26/05/2025

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

3. Punët në proces/Kontrata të zotuar

Aplikanti:

Aplikantët duhet të japin informacion në lidhje me **angazhimet e tyre aktuale** për të gjitha kontratat që i janë dhënë, ose për të cilat është marrë një letër angazhimi ose pranimi, ose për kontratat që i afrohen përfundimit, por për të cilat ende nuk është lëshuar një certifikatë përfundimi të plotë.

Nr.	Emri dhe numri i projektit	Vlera e Kontratës	Adresa e Kontaktit të investitorit, Tel	Vlera e punës së përfunduar Lekë	Data e parashikuar e përfundimit	Data e përfundimit në kontratë
1						
2						
3						
4						
5						

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 018/2025
Projekti: Ruajtja dhe Siguria Fizike	Data e dorëzimit: 26/05/2025

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

4. Ekipi kryesor i propozuar për këtë projekt

Aplikanti:

Ju lutemi plotësoni formularin dhe bashkëngjitni CV-të, Diplomat dhe kontratat e përvojës së mëparshme ose referencat për Menaxherët dhe Specialistët kryesorë që do të punojnë në këtë projekt

Nr	Emër Mbiemër	Data e lindjes	Arsimi	Detyra e caktuar	Licencat	Vite përvojë në detyrën e caktuar
1	Drejtues Ekipi					
2	Mbikëqyrësi i Rojeve					
3	Ekspert IT					

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 018/2025
Projekti: Ruajtja dhe Siguria Fizike	Data e dorëzimit: 26/05/2025

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

5. Deklarata e pranueshmërisë

Aplikanti:

Unë, i nënshkruari

(Emri dhe numri i identitetit të përfaqësuesit ligjor)

Përfaqësues i

(Emri dhe adresa e kompanisë)

Deklaroj se kushtet e mëposhtme janë të zbatueshme për ne;

- Ne jemi një kompani e regjistruar.
- Ne nuk jemi të falimentuar apo në proces falimentimi.
- Ne nuk jemi dënuar për një vepër penale në lidhje me sjelljen profesionale.
- Ne nuk kemi qenë fajtorë për shkelje të rënda profesionale (të vërtetuara me çdo mjet që mund të justifikojnë autoritetet kontraktore).
- Ne kemi përmbushur detyrimet lidhur me pagesën e sigurimeve shoqërore dhe taksave.
- Ne nuk jemi fajtorë për keqinterpretim serioz në dhënien e informacionit.
- Ne nuk jemi deklaruar për faj të rëndë zbatimi për shkak të shkeljes së detyrimeve kontraktuale.
- Ne nuk punësojmë personel nën moshën ligjore të punës.
- Ne ofrojmë të drejtat themelore sociale dhe kushte të drejta pune për punonjësit tanë.
- Ne nuk jemi në asnjë listë të palëve të sanksionuara të lëshuara nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Emri _____ Nënshkrimi _____ Data _____

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 018/2025
Projekti: Ruajtja dhe Siguria Fizike	Data e dorëzimit: 26/05/2025

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

6. Deklarimi i Konfliktit të Interesit

Aplikanti:

Unë, i nënshkruari

(Emri dhe numri i identitetit të përfaqësuesit ligjor)

Përfaqësues i

(Emri dhe adresa e kompanisë)

Deklaroj se:

- Unë ose kompania që përfaqësoj, **nuk** kemi asnjë marrëveshje kompensimi ose interes tjetër ose lidhje me ndonjë drejtor ose menaxher të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit.
- Unë ose kompania që unë përfaqësoj, **nuk** kemi asnjë rrethanë tjetër që, në fakt ose në dukje, mund ta vështirësojë ushtrimin e pavarësisë, gjykimin objektiv ose në ndonjë mënyrë tjetër kryerjen me efektivitet të detyrave të mia si kontraktues, nëse zgjidhet.

Nëse ndonjë nga deklaratat më sipër nuk është e vërtetë ose kërkon shpjegim, ju lutemi përshkruani faktet përkatëse:

Emri _____ Nënshkrimi _____ Data _____

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 018/2025
Projekti: Ruajtja dhe Siguria Fizike	Data e dorëzimit: 26/05/2025

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

Faleminderit për interesimin tuaj për të punuar me Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit